

VENDIM
Nr. 31, datë 27.3.2024

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “COSMOGRAL” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 606/5 prot., datë 20.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Cosmogral’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Cosmogral” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 606 prot., datë 8.2.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 19.2.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 21.2.2024 dhe 22.2.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.3.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 606/3 prot., datë 23.2.2024, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të pa plotësuar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria me shkresën me nr. 606/4 prot., datë 13.3.2024 shoqëria përcolli në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Cosmogral” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar, në zbatim të nenit 9, të rregullores, për pikën 1.1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat: “a”, “b” dhe “c” dhe për pikën 2.4, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Cosmogral” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-(pesë)-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë

Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi